



Enver Hoxha përkujtohet i ndarë



Ne foto: Shoku Hysni Milloshi, Sekretar i Pare i KQ. PKSH

Komunistët e kanë përkujtuar të ndarë udhëheqësin e tyre Enver Hoxha. Ndërsa anëtarët e Partisë Komuniste Shqiptare kanë festuar më datën 12 tetor, dita e diel u ka takuar anëtarëve të Partisë së Punës së Shqipërisë, ndërmjet të cilëve edhe djali i madh, Ilir Hoxha me bashkëshorten Teuta. Adhuresit e Hoxhës kanë ardhur në qytetin e tij të lindjes jo vetëm nga qytete shqiptare, por edhe nga Kosova e Greqia.

Adhuresit

Kolonel Rexhep Krasniqi së bashku me dy miq të tij kanë mbërritur nga Prizreni enkas për ceremoninë përkujtimore. “Sot ndihem jashtëzakonisht i lumtur që ndodhem përpara shtëpisë ku u lind shoku Enver. E kisha parë në fotografi dhe filmime, dhe sot po e shoh nga afër. Kam marrë pjesë edhe në ceremoninë për 95-vjetorin e lindjes. Ne jemi rritur me shokun Enver dhe me Shqipërinë, dhe e duam atë. E duam se për herë të parë në historinë shqiptare një personalitet punoi për të gjithë kombin. Por jemi edhe të indinjuar që gjithë ata breza që u rritën dhe u edukuan në atë sistem e injorojnë”, - shprehet Rexhep Krasniqi.

Nusja lexon letrën përshëndetëse të Nexhmies

Ceremonia përpara shtëpisë së lindjes së Enver Hoxhës ka vijuar me fjalimet e mbajtura, ku është cilësuar si profet dhe gjeni. Nuk ka munguar as përshëndetja e Nexhmie Hoxhës, të cilën në pamundësi të ardhjes e ka lexuar nusja e familjes, Teuta. “Hapja e ceremonive në 100-vjetorin e lindjes së Enverit i përket padyshim Gjirokastrës, në rrugët e së cilës brodhi si fëmijë i gëzuar e më vonë u ul në bankat e shkollës. Gjirokastra e pa djalin e saj komandant të partizanëve, kryetar të PKSH-së e më vonë të PPSH-së, arkitekt të ndërtimit të Shqipërisë e diplomat”, - thuhej në këtë përshëndetje.

Përhapja “Rroftë Enveri” edhe në Librazhd

Në qytetin e Librazhdit, ashtu si dhe në Gjirokastrë, janë shkruar parulla të shumta me bojë të kuqe në përkujtim të 100-vjetorit të lindjes së Enver Hoxhës. Shumë prej tyre janë stampuar në fasadën e rrugës që del nga qyteti në drejtim të Elbasanit, pranë ish-bazës së armatës, e cila u shkatërrua në vitin 1997. M.B.